# AKTI I THEMELIMIT I
# SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# " EKSPRES - BETON LEZHE" sh.p.k

## FORMIMI

Formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar "EKSPRES-BETON LEZHE"Sh.p.k. e ortakut te vetem themelues Gjyste Gjinaj sot me daten 18.03.2004

## S E L I A

Selia e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar "EKSPRES-BETON LEZHE" sh.p.k. eshte ne fshatin Shenkoll Lezhe.Ajo do te hape filiale dhe ne rrethe te tjera brenda dhe jashte vendit.

## KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte mbi 10 vjet.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti I veprimtarise ekonomike te shoqerise "EKSPRES-BETON LEZHE"sh.p.k. eshte:-Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice, import eksport te artikujve te ndryshem ushqimore e Industriale, importimi i makinerive bujqesore, elektroshtepiake, prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, blloqe e soleta betoni, nyje per prodhimin e betonit, tregetim i prodhimeve te betonit dhe elementeve betonarme, pjese kembimi per makina dhe automjete, pike servisi, lavazh makinash, gomisteri, pike shitje me pakice i karburanteve dhe i vajrave lubrifikante si dhe i gazit te lenget me pakice,

## KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themelor i shoqerise eshte 1.000.000(njemilion)leke i investuar ne mase te plote nga ortaku i vetem i saj.

## ORGANET DREJTUESE

Shoqeria tregtare "EKSPRES-BETON LEZHE"sh.p.k. drejtohet nga ortaku dhe administratorja e vetme Gjyste Gjinaj, e cili ka te drejte qe sipas rastit te emeroje administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise. Ajo ka te drejte te caktoje financiere,likujdatore etj si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

ORTAKU I VETEM

**Gjyste Gjinaj**

Gjyste Gjinaj

# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

**"EKSPRES- BETON LEZHE" SH.P.K**

Ne baze te ligjit "Per Shoqerite tregtare 7638 date 19.11.1992, ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te formohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "EKSPRES- BETON LEZHE "sh.p.k. e ortakut te vetem themelues Gjyste Gjinaj.

## DISPOZITA TE PERGJITHSHME

## EMERTIMI I SHOQERISE

NENI 1

"EKSPRES-BETON LEZHE"SH.P.K. me ortak te vetem Gjyste Gjinaj e bija e Frrokut e dt 24.01.1965, me banim ne fshatin Shenkoll te rrethit Lezhe, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar.

## SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EKSPRES-BETON LEZHE "sh.p.k. eshte ne Shenkoll te rrethit Lezhe, ajo gezon te drejten per te hapur filiale , dege apo agjensi te tjera si brenda ashtu dhe jashte vendit

## KOHEZGJATJA

NENI 3

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise "EKSPRES-BETON LEZHE "sh.p.k. eshte mbi 10 vjet , me te drejte riperteritje me vendim te ortakut te vetem.

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 4

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise "EKSPRES-BETON LEZHE "sh.p.k. eshte sa me poshte:-Ne fushen e tregtimit me shumice e pakice, import eksport te artikujve te ndryshem ushqimore e Industriale, importimi i makinerive bujqesore, elektroshtepiake, prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, blloqe e soleta betoni, nyje per prodhimin e betonit, tregetim i prodhimeve te betonit dhe elementeve betonarme, pjese kembimi per makina dhe automjete, pike servisi, lavazh makinash, gomisteri, pike shitje me pakice i karburanteve dhe i vajrave lubrifikante si dhe i gazit te lenget me pakice,

NENI 5

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre Ortaku i Vetem.

Shoqeria me vendim te ortakut te vetem mund te hyje ne marredhenie me shoqeri te tjera te vendit dhe te huaja ne favor te shoqerise "EKSPRES-BETON LEZHE"sh.p.k.

**KAPITALI I SHOQERISE**

NENI 6

Kapitali themelor i shoqerise "EKSPRES- BETON LEZHE"sh.p.k. eshte 1.000.000 (nje milion) leke i inevstuar ne mase te plote prej Ortakut te vetem te saj.

**DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

NENI 7

Shoqeria "EKSPRES- BETON LEZHE"sh.p.k.eshte prone e Ortakut te vetem te saj, i cili gezon te gjitha atributet e Asamblese se Shoqerise .

Administratore e shoqerise do te jete Gjyste Gjinaj.

NENI 8

Sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise Ortaku i vetem emeron e puneson administratore te cilet qendrojne ne detyre derisa revokohen nga shoqeria ose largohen me deshiren e tyre. Administratori i emeruar i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer te shoqerise me perjashtim te rasteve te vecanta qe ligji i jep shprehimisht Ortakut te vetem.

**MARREDHENIET E PUNES**

NENI 9

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes.

## PERFAQESIMI I SHOQERISE

NENI 10

Perfaqesimi i shoqerise "EKSPRES- BETON LEZHE"sh.p.k. i perket Ortakut te vetem te saj si dhe administratores se saj z.Gjyste Gjinaj Ne mungese te tij shoqeria administrohet nga perfaqesuesi ligjor me prokure te noterizuar vetem sipas tagreve te caktuara ne prokure.

## KONTROLLI I BRENDSHEM

NENI 11

Shoqeria tregtare organizon kontrollin e brendeshem me nje ekspert kontabel te autorizuar i cili eshte pergjegjes para kesaj Shoqerie per demet qe mund te shkaktoje nga moskryerja ne rregull e detyres se tij.

## BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 12

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti pervec rasteve e urdherave te vecanta te ortakut te vetem te saj. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME.

Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 mars te vitit pasardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale, pjesa qe mbetet i jepet per perdorim Ortakut te vetem te saj.

NENI 13

Pasuria e shoqerise eshte lirisht e trashegueshme ne rruge trashegimie.

## SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 14

Shperberja e shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cdo lloj shkaku. Ne rast mbylljeje Ortaku i vetem vendos per menyrat e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdatore duke iu percaktuar edhe detyrat. Ne rastin e likujdimit emertimi i shoqerise do te shoqerohet me shenimin:

SHOQERI NE LIKUJDIM E SIPER. Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likujdimit dhe kryhen formalitetet e duhura, shoqeria çrregjistrohet nga rregjistri tregtar i asaj gjykate.

**DISPOZITA TE TJERA**

NENI 15

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut i referohet plotesimeve te bera nga administratori i saj.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**
Gjyste Gjinaj

Lezhe, me 18.03.2004

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE LEZHE
Nr 571 Rep Nr 181 Kol

**V E R T E T I M**

Sot me daten 18.03.2004 Ne zyren e noterise ne Lezhe para meje noterit Vasil Martini u paraqit kerkuesi Gjyste Gjinaj e bija e Frrokut, e dt 24.1.1965 me banim ne Shenkoll te rrethit Lezhe, madhor me zotesi te plote per te vepruar. Per identitetin e te cilit u sigurova nga njohja personale, i cili me deklaroi se Statuti i mesiperm eshe bere me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe u nenshkrua para meje noterit, dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

N O T E R I
Vasil Martini